



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/97
Datë: 20.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë i Republikës së Kosovës Nr.01/85 i datës 29 qershor 2022, në paragrafin 2, ku togfjalëshi "30 shtator 2022" zëvendësohet me "31 tetor 2022".
2. Të gjitha pikat tjera të Vendimit Nr.01/85 të datës 29 qershor 2022 mbesin të pandryshuara.
3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/97

Datë: 20.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23, paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-021, Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimin e Qeverisë lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike Nr.13/19 të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet dyfishimi i pagesës për përfituesit e skemës së ndihmës sociale për muajin Shtator 2022, në kuadër të zbatimit të masës 3.2- Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Për zbatimin e pikës 1. të këtij Vendimi, Thesari i Kosovës autorizohet paraprakisht, të bëjë alokimin e parakohshëm të mjeteve buxhetore nga programet përkatëse buxhetore, për përmbushjen e plotë të këtij Vendimi.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e plotë të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/97
Datë: 20.09.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin e Qeverisë Nr. 01/60 të datës 05.02.2022, Vendimin e Kuvendit Nr. 1800/3 të datës 09.08.2022, për miratimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/91 të datës 31.07.2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje të mjeteve buxhetore në vlerë prej 19,000,000 € (nëntëmbëdhjetë milionë euro), për zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, në kuadër të masës 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213 në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11313, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi përdoren për qëllim të subvencionimit të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë, me qëllim të uljes së ndikimit të tarifave të energjisë, e cila pastaj reflektohet edhe në faturat e konsumatorëve.
4. Kushtet dhe kriteret e shfrytëzimit të mjeteve nga pika 1. e këtij Vendimi përcaktohen me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 21/94 të datës 24 gusht 2022.
5. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e projektit (00098) të organizata buxhetore dhe programit përkatës.
6. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/97
Datë: 20.09.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendim Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin të Qeverisë Nr. 01/60 të datës 05.02.2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje të mjeteve buxhetore në vlerë prej 6,000,000 € (gjashtë milionë euro), për zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, në kuadër të masës 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213 në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod të programit 11313, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e projektit (00098) te organizata buxhetore dhe programit përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/97
Datë: 20.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 5, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shpallja me interes të veçantë publik e pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat janë të nevojshme për realizimin e "Projekteve Infrastrukturore për Interes Publik", Zonat Kadastrale: Bërnjak dhe Jasenovik i Epërm, Komuna Zubin Potok, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), në koordinim me Ministrinë përkatëse të inicojë procedurat e shpronësimit të pronave të paluajtshme konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave Punës dhe Trasfereve.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/97
Datë: 20.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Enërgjinë, nenet 11 dhe 29 të Ligjit Nr. 08/L-21 për Tregtinë me Jashtë, nenet 42 dhe 43 të Ligjit Nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, Vendimin Nr. 1800/3 të datës 09.08.2022 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/91 të datës 31.07.2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Për kohëzgjatjen e masave emergjente për furnizimin me energji me Vendimin Nr. 1800/3 të datës 09.08.2022 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/91 të datës 31.07.2022, ndalohet përkohësisht eksporti dhe ri-eksporti i produkteve të drurit si lëndë djegëse nga Kreu 4401 i Tarifës së Integruar të Kosovës (TARIK) të vitit 2022.
2. Obligohet Dogana e Kosovës dhe autoritetet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky Vendim nuk përjashton nga detyrimet dhe kufizimet tjera sipas legjislacionit në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Doganës së Kosovës
- Arkivit të Qeverisë